

Drive

PORSCHE
ALBANIA

12/16

8 **E-Drive**

16 **SEAT Ateca**

18 **Crafter2Craftsmen**

12 **ŠKODA KODIAQ**



> Përmbajtja Content



E-Drive



ŠKODA e re KODIAQ
The new
ŠKODA KODIAQ



Driven by nature



5001 ARSYE
MË SHUMË
5001 Arsyë
5001 Reasons

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.
Realizimi: Botues Porsche Albania,
Realizimi grafik: Sourceone

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com,
SEAT: media.SEAT.com,
Volkswagen Makina Tregtare:
volkswagen-media-services.com,
Volkswagen Magazine
ŠKODA: press.ŠKODA-auto.com.

Për komente, pyetje apo sygjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania,
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rr. Monun.
Telefon: +355 (04) 240 74 30, Fax.: +355 (04) 240 74 34,
e-mail: office@porsche.al; http://www.porsche.al

16

SEAT Ateca



20

Audi Q5.



18

Crafter2Craftsmen



I dashur lexues, Dear Reader,

Dorian Mehmeti - Drejtor Marketingu Porsche Albania
Marketing Manager Porsche Albania



Të pakta janë ato industri që mund të krenohen me ritmin e lartë të ndryshimeve në kohë si industria e makinave. Industria automobilistike është padyshim në frontin e parë të zhvillimeve teknike. Prej kohësh tashmë është hapur sipari i ndryshimeve që priten të revolucionarizojnë rrënjësisht tregun e makinave. Zhvillimet e fundit teknologjike, kërkesa për modernizim të mënyrës së të udhëtuarit por edhe ndryshimet në legjislacion priten të rikonfigurojnë udhëtimin me makinë.

Një ndër aspektet më të rëndësishme të këtyre ndryshimeve është prezantimi dhe komercializimi i elektricitetit si karburanti i ri i

lëvizjes. Fosilizimi i lëndëve djegëse fosile u shoqërua me identifikimin e një lloji të ri karburanti siç është 'energja elektrike'. Në Porsche Albania ne mendojmë se prezantimi i kësaj teknologjie, në tregun vendas, nuk është i parakohshëm. Falë partneritetit me institucione të ndryshme publike, kemi sjellë në treg (ndër vendet e para të rajonit) makinat 100% elektrike, Volkswagen e-Golf. (faqe 8)

"Driven by nature" slogani që na shoqëroi gjatë 2016, ishte edhe struktura ku ne konceptuam ofertat apo aktivitetet tonë këtë vit nga ku mund të veçojmë: pjesëmarrjen në edicionin e parë të panairit të makinave

fuel for. The fossilization of fossil fuels was accompanied by the identification of a new type of fuel, such as 'electricity.' At Porsche Albania, we think that the introduction of this technology to the domestic market is not premature. Thanks to partnerships with various public institutions, we have brought to the market (among the first countries in the region) the 100% electric cars, Volkswagen e-Golf. (page 8)

"Driven by nature," the slogan that accompanied us during 2016, was the structure where we conceived our offers or activities during this year and here we could point out: participation in the first edition of the

'Autosalloni 2016', oferta më e ndjekur në treg "5001 Arsye" nga ŠKODA (faqe 14), prezantimi i Audi Q7 e-tron si edhe SEAT-it të ri Ateca (faqe 16).

Një vëmendje të veçantë u kemi kushtuar modeleve të reja që presim në gjysmën e parë të 2017 nga ku do veçonim, Audin Q5, ŠKODA Kodiaq dhe Volkswagen Crafter.

Këto por edhe shumë më tepër, mbi të rejat më të fundit që do na shoqërojnë përgjatë 2017, do keni mundësi ti lexoni në faqet në vijim.

Lexim të mbarë.

car fair 'Auto Salon 2016', the most followed offer in the market "5001 Reasons" from ŠKODA (page 14), the introduction of the Audi Q7 e-tron as well as the new SEAT Ateca (page 16).

We devoted special attention to the newest models we expect during the first half of 2017, whereby we would single out the Audi Q5, ŠKODA Kodiaq and Volkswagen Crafter.

You may read about these and much more on the latest novelties that will accompany us during 2017 in the following pages.

Enjoy.



Few are those industries that could take pride in the fast pace of change through time as the car industry. The automotive industry is without a doubt at the front line of technical developments. For a long time now, the door of changes expected to substantially revolutionize the vehicle market has been opened. The latest technological developments, the demand for modernizing the travel mode, but also changes in legislation are expected to reconfigure the way of driving.

One of the most important aspects of these changes is the introduction and commercialization of electricity as the new

Qendra Moderne e Trajnimit

State of the art training Center



Pas hapjes kohët e fundit të qendrës së saj të re të trajnimit dhe zhvillimit në Alpenstraße të Salzburgut, Porsche Holding

Salzburg vazhdon të zgjerojë përparësinë e saj konkurruese për shërbime të shkëlqyera. Kompania investoi shtatë milionë euro në ndërtesën e re që ka mjediset më moderne të mundshme, ku rreth 3,900 teknikë servisi dhe 150 stazhierë do të trajnohen çdo vit.

"Automjetet e sotme përdorin një teknologji aq komplekse sa që zhvillimi i vazhdueshëm është i domosdoshëm. Kjo ka vlerë sidomos për trajnimin profesional dhe mundësitë për zhvillim për personelin tonë, të cilët tani kanë mjedise të shkëlqyera në qendrën tonë të re," shpjegon Alain Favey, CEO i Bordit të Menaxhimit të Porsche Holding Salzburg.

Teoria dhe praktika kombinohen në mënyrë të përsosur në konceptin një-dhomësh në qendrën e re të trajnimit. Kjo do të thotë se teoria dhe trajnimi praktik zhvillohen në një sallë, çka siguron largësi të shkurtra mes sesioneve të mësimi dhe është ideale për kalimin e dijeve praktike.



Having recently opened its new training and development centre in Salzburg's Alpenstraße, Porsche Holding Salzburg is continuing to expand its competitive edge in service excellence. The company invested seven million euros in the new building with state-of-the-art facilities, where some 3,900 service technicians and 150 apprentices will be trained every year. "Today's vehicles use such complex technology that continuous development is imperative. This applies in particular to the

Mjediset e mësimi kanë standardet më të larta teknike. Urat plotësisht të përshtatshme, pajisjet më të fundit për diagnostikim, hapësira të veçuara për trupin e makinës me një dhomë të posaçme për punë saldimi, sistemet e konvergencës dhe pajisje të tjera sigurojnë një mjedis optimal për të mësuar. Pjesëmarrësit në trajnime kanë në dispozicion njëzetë makina të ndryshme për trajnim praktik, të cilat variojnë nga Audi A8, Caddy me gaz natyror dhe T6 deri tek VW Up! Trupa makine në të bardhë janë në dispozicion për të praktikuar montime dhe riparime strukturore. Mjediset e trajnimit janë pajisur me ajër të kondicionuar dhe ndriçim LED në të gjitha dhomat me qëllim që për pjesëmarrësit të garantohen kushtet më të mira të mundshme për punë dhe mësim. Me mesatarisht dymbëdhjetë pjesëmarrës, kurset sigurojnë që secili individ të marrë vëmendjen e duhur.

Personeli i super-trajnuar rrit konkurrueshmërinë e ekspertizës

Duke qenë se Porsche Holding gjithmonë i ka kushtuar rëndësi të madhe trajnimit dhe

professional training and development opportunities for our staff, who now find excellent amenities at our new centre", explains Alain Favey, CEO of the Porsche Holding Salzburg Management Board.

Theory and practice are perfectly combined in the one-room concept at the new training centre. This means that theory and practical training are held in one room, which ensures short distances between sessions and is ideal for hands-on knowledge transfer.

zhvillimit, kjo shihet qartë tek karrierat e personelit këtu. Gjatë stazhit të tyre, ekspertët e ardhshëm të servisit jo vetëm që i nënshtrohen trajnimit të thelluar, por edhe marrin pjesë në kurse të ndryshme që i përgatisin për detyrat e vështira përpara. Vetëm nëse qendrat e servisit dhe riparimit të markës kanë një ekip që është i përditësuar atëherë ato mund të ofrojnë standard të lartë cilësie dhe të vazhdojnë të rrisin përparësinë konkurruese të ekspertizës së tyre. Personeli i super-trajnuar përbën faktorin vendimtar të suksesit për riparimin e defekteve shpejt dhe në fund për të siguruar që klientët të jenë të kënaqur.

Përveç mjediseve të trajnimit në Salzburg, Porsche Holding Salzburg administron edhe dhjetë qendra të tjera në të gjithë Austrinë me 20 trajnues gjithsej. Çdo vit, këtu zhvillohen rreth 850 aktivitete trajnimi nga rreth 60 kurse.

Burimi: porsche-holding.com

The teaching facilities are of the highest technical standard. Fully adjustable car lifts, the latest diagnostic equipment, separate body bays with a dedicated room for welding work, level wheel alignment systems and other equipment ensure an optimum training environment. Twenty different vehicles are available to course participants for practical training, ranging from the Audi A8, natural gas Caddy and T6 to the VW up!. Bodies in white are also on hand for them to practise assembly and structural repairs. The training





facilities have been equipped with air conditioning and LED lighting in all the rooms in order to guarantee participants the best possible conditions for working and learning. With twelve participants on average, the courses make sure that each individual receives appropriate attention.

Highly trained staff expand competitive edge in expertise

As Porsche Holding has always attached

great importance to training and development, it features prominently throughout staff careers here. During their apprenticeships, future service experts not only undergo in-depth training but also attend various courses to prepare them for the demanding tasks ahead. Only if the brand service and repair centres have a team that is up to date can they provide a high standard of quality and continue to expand their competitive edge in expertise. Highly trained staff are the decisive success factor in repairing faults quickly and

ultimately ensuring satisfied customers.

In addition to the training facility in Salzburg, Porsche Holding Salzburg operates ten other centres across Austria with a total of 20 trainers. Every year, around 850 training and development events from a range of some 60 different courses are held there.

Source: porsche-holding.com

Sinergji në shërbim

Synergies in service

Raimond Zhegu - Drejtor servisi në Porsche Albania
Service Manager at Porsche Albania



> Blerja e një makine të re nënkupton edhe vendosjen e një marrëdhënie afatgjatë me ekipin e servisit të asaj përfaqësie, të cilës i përket marka e makinës që po zgjedh. Shërbimet periodike të makinës bëjnë që kontakti i klientit me departamentin e shërbimeve të pas shihtës të një konçesionari të jenë të vazhdueshme. Në Porsche Albania e dimë se nëse një klient vjen 2-4 herë për të përzgjedhur dhe konfiguruar makinën e tij të re, për shërbimet periodike do të vijë mesatarisht 2 herë në vit për të gjithë kohëzgjatjen e përdorimit të makinës së tij. Për këtë arsye, ne tentojmë jo vetëm të

shkurtojmë kohën e tij të pritjes, por të shtojmë vlerë në çdo vizitë të tij.

Gjatë këtyre gjashtë muajve të fundit, servisi në Porsche Albania ka përjetuar ndryshime të rëndësishme ku vlen të theksohet shtimi i kapaciteteve të shërbimit për makinat 100% elektrike ose atyre hibride. Tashmë jo vetëm një hapësirë e dedikuar për këto dy teknologji të reja por edhe pajisje diagnostifikuese dhe mekanikë të trajnuar për to.

Një tjetër element i rëndësishëm është garancia opsionale e shtuar për markën ŠKODA ku nga dy vitet bazë, klienti mund të

përzgjedhë edhe dy vite të tjera ekstra (ose deri në 120,000 km) për të qenë edhe më i qetë për mbarëvajtjen e makinës së tij.

Në Dhjetor përfundoi edhe çertifikimi i mekanikëve për procedurat më të reja të markave të grupit Volkswagen.

Falë punës së vazhdueshme të të gjithë ekipit në fund të këtij viti shohim me krenari jo vetëm një bilanc shumë pozitiv financiar, por mbi të gjitha klientë gjithmonë e më tepër të kënaqur.

> Buying a new car also means establishing a long-term relationship with the service team of the dealership that provides the car brand that you are buying. Periodic service for the car make the customer's contact with the service department after the purchase of a car a constant. At Porsche Albania, we know that while a customer comes 2 to 4 times to select and configure his new car, he will come on average 2 times a year for the duration of the use of his car. That is the reason why we try, not only to shorten the time he has to wait, but also to add value to every visit by him.

During the past six months, the service department at Porsche Albania has experienced major changes, whereby it is worth mentioning the addition of service capacities for 100% electric or hybrid cars. Now, we have not only the space dedicated to these two new technologies, but also the diagnosing equipment and the trained mechanics for them.

Another important element is the optional warranty added for the ŠKODA brand; in addition to the two basic years, the customer may select another two additional years (or up

to 120,000 km) in order to have greater comfort about how his car is doing.

In December, the certification of mechanics for the latest procedures of the Volkswagen Group brands was completed.

Thanks to continued work by the entire team, at the end of this year, we see with pride not only a very positive balance sheet but, above all, increasingly satisfied customers.

Driven by nature

> Jemi pak kompani që operojmë në tregun automotiv Shqiptar dhe që ndajmë pasionin sfidues, jo vetëm për makinat por edhe për adaptimin e teknologjive më të reja. Ne në Porsche Albania duam të jemi të parët në këtë fushë dhe për këtë kemi dhënë prova në vitin që po lëmë pas.

Vetëm pasioni dhe vizioni afatgjatë për pozicionin në treg, të çon në vendimmarrje të guximshme për të sjellë vlerë konkrete në atë çka ofron.

Pas disa vitesh, tregu i makinave të reja në vend, këtë vit përjetoi një rritje të moderuar rreth 19% krahasuar me vitin 2015 edhe pse në vlerë totale vazhdon të mbetet shumë i vogël, ne e konsiderojmë këtë si një zhvillim tepër pozitiv. Në vlerësimin tonë në Porsche Albania, një numër tenderash publikë e privatë, konsolidimi i mëtejshëm i institucioneve financiare, stabiliteti makroekonomik, por edhe iniciativat e operatorëve në treg për të zhvilluar biznese që kanë të bëjnë me transportin, janë disa prej nxitësve të tregut automobilistik shqiptar.

Problematikat Shqiptare e bëjnë të vështirë vendosjen në një plan primar të tendencave më të fundit Europiane me nevojat e tregut vendas, por ne në Porsche Albania mendojmë ndryshe.

Viti 2016 do të mbahet mend pasi për herë të parë në Shqipëri prezantohen jo thjesht modele të reja, por teknologjitë më moderne të kohës si ajo e makinave 100% elektrike. Në këtë plan 'Driven by nature' ka qenë shumë më tepër se slogani i pjesëmarrjes sonë në panairin Autosallon 2016. Një filozofi e re në funksion të minimizimit të impaktit në mjedis falë ndotjes ZERO si dhe e përfaqimit të teknologjive të së ardhmes.

Në Tetor të këtij viti, Porsche Albania, duke u bërë kompania e parë dhe pionierja e vetme në Shqipëri (si dhe ndër kompanitë e para në Ballkan) dorëzoi 11 makinat e para 100% elektrike Volkswagen e-Golf, të cilat janë sot në përdorim të Policisë Rrugore, Tiranë.

Mbulimi i gjerë mediatic, na dha mundësinë që të fillonim një 'bisedë' për atë çka deri dje ishte tërësisht e panjohur, elektricitetin si "karburantin" e ri të lëvizjes. Pas gjithë debatit, me kënaqësi vë re, që pyetjet mbi modelat elektrike por edhe kërkesat e shumta për të provuar makinat elektrike flasin për një fillim të mbarë.

Gjithashtu prezantimi i Q7 e-tron për herë të parë në Shqipëri një plug-in Hibride i shtëpisë prodhuese me katër rrrathë, AUDI. Një motor elektrik me autonomi prej 55 km dhe një motor me naftë 3.0 TDI. Një tjetër sukses që jetkaloj pritshmëritë tona për këtë model.

Megjithatë dihet se në ekuacionin e ndërlikuar të ndotësve të ambientit një vend të rëndësishëm zënë makinat e vjetra. Them i ndërlikuar, pasi nevoja ekonomike për lëvizshmëri përballet me nivele të larta emetimesh të këtyre makinave. Pas një pune të gjatë dhe në bashkëpunim me prodhuesin ŠKODA ne sollëm fushatën '5001 Arsye' ku çdo klienti që zgjidhte një ŠKODA Yeti ne i ofronin mundësinë që t'i blinin mbrapsht makinën e vjetër (të çdo marke, moshe apo gjendje) për 5,000 Euro, te cilat do të kalonin si zbritje në çmimin e makinës së re Yeti dhe makina e vjetër e blerë nga ne do të dilte nga qarkullimi. Suksesi i kësaj oferte, por edhe puna e vazhdueshme e ekipit ŠKODA bën që kjo markë të renditet e para (për të tretin vit radhazi) në tregun e makinave të pasagjerëve në Shqipëri.

Po në Tetor 2016, Porsche Albania prezantoi (paralelisht me tregjet më të mëdha Europiane) SEAT Ateca-n e re. Ndërmjet të ftuarish dhe të apasionuarish pas tregut të makinave, në panairin e makinave Autosallon 2016, u prezantua modeli i parë SUV nga SEAT. Një model jo vetëm elegant e dinamik, por falë teknologjisë 'Ecomotive' edhe një përfaqësues i denjë i filozofisë tonë 'Driven by nature'.

Në sajë të një pune të vazhdueshme, por mbi të gjitha falë mbështetjes së klientëve dhe partnerëve tanë, sot Porsche Albania vazhdon

të jetë kompania e parë në tregun automotiv Shqiptar, i cili pas disa vitesh rënie, ndjeu këtë vit konsolidimin e fillsave te një rritjeje të brishtë por optimiste.

Ky botim shërben për të ndarë gjithashtu së bashku atë çka viti 2017 na rezervon. Viti që vjen nuk do të jetë i lehtë si nga ana politike, por edhe çështjeve që një vit zgjedhor përmban e sjell me vete, por ne jemi të përgatitur dhe të fokusuar në strategjinë tonë të mirë-menduar që t'ju shërbejmë si në departamentin e shitjes ashtu edhe atë të pas shitjes partnerëve, klientëve dhe konsumatorëve tanë. Të lehtësojmë dhe optimizojmë, më tej, kostot e transportit, jo vetëm me produktet më të reja, por edhe me bashkëpunimin e kompanisë si motër Porsche Leasing me anë të financimeve të projekteve tuaja.

Një ofensivë modelesh të reja, ku segmenti SUV dhe SUV-Kompakt por jo vetëm, do të pasurohet me disa prurje nga markat tona nga të cilat do të veçoja: Audi-n Q2, Audi Q5, ŠKODA Kodiaq, ŠKODA-n e re Yeti. Përmirësimi në stilizim i modelit Octavia dhe Rapid për ŠKODA-n, Volkswagen Golf dhe atij up! E ndërsa në tregun e makinave tregtare risia e shumë pritur do të jetë Volkswagen Crafter i ri i cili është totalisht i ndryshuar në paraqitje, motor por edhe në çmim. Një përmirësim i dukshëm në favor të blerësve. Makinat elektrike do të vazhdojnë të jenë në qendër të komunikimit tonë, ku për të ftuar kuriozët dhe të apasionuarit për të provuar këto modele, kemi krijuar edhe website-n e dedikuar www.e-drive.al.

'Driven by nature' do të kornizojë komunikimin tonë edhe në këtë vit që vjen.

Si në çdo botim të fundvitit, kam kënaqësinë, që në emër të stafit të Porsche Albania-s, por edhe timin personal, t'ju uroj Gëzuar Festat e Fundvitit dhe një Vit të Ri të suksesshëm 2017.



Gentian Bushati - Drejtori i Përgjithshëm Porsche Albania
General Manager Porsche Albania

> We are only a few companies operating in the Albanian automobile market that share the challenging passion not only for cars but also for adapting to the newest technologies. We at Porsche Albania want to be the first in this field and we have given proof of that also during the year we just left behind.

Only the passion and the long-term vision for the market position lead one to courageous decisions in order to bring concrete value with what you offer.

After a few years, the new vehicle market in the country for this year experienced a moderate growth of 19% compared to 2015. Although in total value, it is still small, we consider it a very positive development. In our opinion at Porsche Albania, a number of public and private tenders, the further consolidation of financial institutions, macroeconomic stability, but also initiatives by operators in the market to develop businesses related to transport are some of the incentives for the Albanian automobile market.

It is a common belief that due to the Albanian market size it would be difficult to give a primary standing to the latest European trends with the needs of the domestic market, but at Porsche Albania we think differently.

2016 is a year to remember because for the first time in Albania we introduced the 100% electric vehicles. In this context, 'Driven by nature' has been much more than the slogan for our participation in the Auto-salon 2016. A new philosophy as a function of minimizing the impact on the environment thanks to ZERO pollution and the embracing of technologies of the future.

In October this year, Porsche Albania, became the first pioneering company in Albania (and among the first companies in the Balkans) delivered the first 11 new 100% electric Volkswagen e-Golf cars, which are now in use by Traffic Police in Tirana. The extensive media coverage gave us the

opportunity to start a conversation with what until yesterday was entirely unknown, electricity as the new "fuel" for movement. Following the debate, I notice with pleasure that all the questions as well as the numerous demands to try electric cars speak to a good start.

Also, the introduction of the Q7 e-tron for the first time in Albania, a hybrid plug-in of the four circle car making company, AUDI. An electric engine with a range of 55 km and a 3.0 TDI diesel engine. This was another success that went beyond our expectations for this model.

However, it is known that old cars take up an important place in the complicated equation of environment polluters. I say complicated because economic need for mobility faces high emission levels of these cars. After a long hard work in cooperation with the ŠKODA manufacturer, we brought the campaign '5001 Reasons,' whereby to every client choosing a ŠKODA Yeti we offered the possibility to buy back his old car (of any brand, age or condition) for 5,000 Euro, which would be used to reduce the price of the new Yeti car and the old car would be removed from circulation. The success of this offer but also the continued work of the ŠKODA team makes the brand rank first (for the third year in a row) in the passenger vehicle market in Albania.

Also in October 2016, Porsche Albania introduced (in parallel with the larger European markets) the new SEAT Ateca. Among invitees and car market aficionados, we introduced the first SUV model of SEAT at the Auto-Salon 2016 car fair. This is a model that is not only elegant and dynamic but, thanks to 'Ecomotive' technology, also a worthy representative of our 'Driven by nature' philosophy.

Thanks to continued work, but above all thanks to support by our clients and partners, today Porsche Albania continues to be the leading company in the Albanian automotive market, which after some years of decline, felt

this year the beginnings of a fragile but optimistic growth.

This publication is also for sharing together what 2017 has in store for us. The coming year will not be easy, both politically speaking, but also because of the issues that an electoral year brings with it; however, we are prepared and focused on our well-thought strategy to serve both in the sales department and the post-sales department to our partners, clients and customers. We seek to further facilitate and optimize transport costs, not only through the newest products but also in cooperation with the affiliate company Porsche Leasing through funding your projects.

An offensive of new models, whereby the SUV and SUV-Compact segment but not only will be enriched with some new entries from our brands, among which I would point out: Audi Q2, Audi Q5, ŠKODA Kodiaq, and new ŠKODA Yeti. The style improvements of the Octavia and Rapid models for ŠKODA, Volkswagen Golf and the up! model. Meanwhile, the market of commercial vehicles will include the much-awaited entry of the new Volkswagen Crafter that is completely changed in its appearance but also in price, with evident benefits toward the buyers.

Electric cars will continue to be at the center of our communication. In order to invite the curious and the aficionados to try these models, we have created the dedicated website www.e-drive.al.

'Driven by nature' will frame our communications this coming year too.

As in every publication at the end of the year, I have the pleasure, on behalf of the staff of Porsche Albania and on my behalf, to wish you Happy Holidays and a successful New Year 2017!



E - Drive

Më shumë energji në rrugët e qytetit

More power to the city



Me një konsum prej vetëm 12.7 kWh për 100 km (afërsisht 150 lekë në ditë), ato janë një ëndërr që bëhet realitet për këdo që dëshiron një makinë me konsum të ulët. Ulja e kostove të përdorimit që mundësohen nga këto mjete është mesatarisht 7-fish me motorët e naftës dhe 10-fish me ato të benzinës. Gjithashtu nëse llogarisim që automjetet elektrike nuk kanë nevojë për shërbime periodike (vaj+filtra) kursimi është edhe më i madh. Ato janë të pajisura me kabull dhe adaptor në mënyrë që të mundësojnë karikimin nga çdo prizë e zakonshme. Me anë të kësaj metode të thjeshtë, arritja në 100% të kapacitetit të baterisë, kërkon 8-12 orë. Megjithatë, për ata që e kanë me ngut, teknologjia e zhvilluar nga Volkswagen dhe partnerët e saj, mundëson karikimin e shpejtë prej vetëm 30 minutash të 80% të kapacitetit të baterisë.

Kostoja dhe ndikimi pozitiv në mjedis ishte një nga arsyet kryesore pse edhe Policia e Shtetit Shqiptar zgjodhi makinat elektrike, si zgjidhje për punonjësit e policisë, kryesisht të qarkullimit rrugor.

Këto makina janë ekonomike, miqësore me mjedisin dhe shumë të rehatshme: kaq mjaftoi

për ta kthyer Shqipërinë në vendin e parë në rajonin e Ballkanit dhe në një nga pesë shtetet në të gjithë Evropën, që ka në përdorim makina elektrike. Në krahasim me mjetet normale të policisë, të cilat harxhojnë deri në 14 litra benzinë në ditë, mjetet elektrike harxhojnë vetëm 150 lekë energji për 100 km. Konsumi i energjisë së ruajtur në makinë kontrollohet nëpërmjet aparaturave në kruskot dhe asnjëherë nuk ka rrezik të të lërë në rrugë. Janë shumë praktike për rrugët e Tiranës, duke filluar nga përmasat e tyre, janë të rehatshme në trafik, si dhe nuk bëjnë zhurmë gjatë punës.

Porsche Albania është ndër konçesionarët e parë në rajon që ofron mundësi shiteje dhe servisi për mjetet e kësaj teknologjie. Nga ana tjetër, kontrolli periodik i makinave elektrike ndryshon shumë nga ai i makinave me motor me djegie të brendshme. Makinat elektrike, në kontrollin periodike dhe shërbimet e tyre, kufizohen vetëm në ndërrimin e filtrit të kondicionerit, që do të thotë jo më vaj motori dhe filtër vaji, jo më filtër karburanti dhe jo më filtër ajri për motorin. Kurse ndërrimi i ferrotave bëhet për një kohë tre herë më të gjatë se sa makinat normale sepse frenimi i moderuar kryhet nëpërmjet motorit elektrik.

Prurja e teknologjive të reja paralelisht me vendet më të zhvilluara Europiane, është pjesë thelbësore e strategjisë së Porsche Albania. Për këtë arsye, konçesionari po punon intensivisht për të zhvilluar kapacitetet në servis për të trajtuar këto mjete. Trajnimet e vazhdueshme të stafit, pajisjet e reja që do të bëjnë karikimin e shpejtë apo diagnostifikimin, janë vetëm disa nga hapat e ndërmarra për të ofruar një shërbim cilësor për drejtuesit e këtyre mjeteve.

Ndoshta, shkencëtarët e shekullit të XIX-të nuk e imagjinonin dot këtë zhvillim në teknologjinë e sotme, madje as manjatët e naftës që e rrotulluan botën rreth "arit të zi" të tokës, por për ne është e qartë se e ardhmja jonë i takon automobilave elektrike. Është mënyra jonë si të kursejmë dhe ruajmë mjedisin në të njëjtën kohë.

Bën sens për një vend si Shqipëria, që 97% të energjisë që prodhon, e ka të rinovueshme. Pra pa efekte negative në mjedis.



With a consumption of only 12.7 kWh per r 100 km (approximately 150 ALL a day), they are a dream come true for everyone wishing for a low consumption vehicle. The reduction of use costs enabled by these vehicles is on average 7 times compared to diesel engines and about 10 times compared to gasoline engines. Also, if we factor in the fact that electric vehicles do not need periodic service (oil+filters), saving is even greater. They are equipped with cable and adaptor in order to enable charging from any ordinary socket. Through this simple method, reaching 100% of the battery capacity lasts no more than 8-12 hours. However, for those in a hurry, the technology developed by Volkswagen and its partners enables fast charging for up to 80% of the battery capacity in only 30 minutes.

The cost and the positive impact on the environment were some of the main reasons why Albanian State Police chose electric cars as a solution for police officers, mainly those working on traffic.

These cars are economic, environment-friendly and very comfortable: that was enough to turn Albania into the first country in the Balkan region and one of the five

countries in all of Europe to be using electric cars. Compared to normal police vehicles, which consume up to 14 liters of gasoline a day, electric vehicles only consume 150 ALL of energy for 100 km. The consumption of energy stored on the vehicle is checked through equipment on the dashboard and there is never a risk of being stuck on the road. They are very practical for the streets of Tirana, starting with their dimensions; they are comfortable in traffic and make no noise while on.

Porsche Albania is among the first dealers in the region to provide the possibility for the sale and service for vehicles with this technology. On the other hand, the periodic service of electric vehicles is very different from that of vehicles with internal combustion engines. Electric cars, in their periodic controls and service, are only limited to changing the air conditioning filter, which means no more engine oil and oil filter, no more fuel filter and no more air filter for the engine. As per the replacement of brake pads, that takes place after a period that is three times longer than that of normal cars because moderate braking is done through the electric engine.

The introduction of new technologies in parallel with the more developed European countries is an essential part of the strategy of Porsche Albania. Therefore, the dealer is working intensively to develop the capacities in the service shop for handling these vehicles. Continued staff training, the new equipment that will do the fast charging or diagnosis, are only a few of the steps undertaken to provide quality service for the drivers of these vehicles.

Maybe the XIX century scientists could not imagine this development in today's technology; nor the oil magnates who got the world to revolve around the "black gold" of the earth, but for us it is clear that our future belongs to electric vehicles. It is the way to save and preserve the environment at the same time.

It makes sense for a country like Albania given that 97% of the energy it produces is renewable. In other words, it has no negative impact on the environment.

Grupi Financiar Porsche

Një kompani me traditë

Porsche Financial Group

A company with tradition



Historia e Grupit Financiar Porsche ka filluar në vitin 1966, kur Porsche themeloi kompaninë e parë leasing, me qendër në Salzburg, Austri (sot

e njohur si Porsche Bank). Rritja e vazhdueshme në biznesin e leasing-ut çoi në vitin 1985, në rritjen e të njëjtës kompani në një institucion financiar, me shumë i specializuar e me një fokus në shitjen e makinave - Porsche Bank AG.

Në fillim të viteve 1990, Porsche vlerësoi mundësitë në zhvillim në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, dhe zgjeroi fushën e aktivitetit në vende si Hungaria, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Ukraina, Kroacia, Shqipëria dhe Bosnje - Hercegovinë. Sot, Porsche Bank operon gjithashtu edhe në Amerikën e Jugut, në Kolumbi dhe Kili.

Përvjetori i Porsche Bank 50 vjet në biznes

Zhvillimi i Porsche Bank Group, nga një ndërmarrje tradicionale austriake në një kompani ndërkombëtare me fokus automjetet, është e mahnitshme. Në vitin e tij jubilar - me më shumë se 900.000 kontrata financimi, sigurimi e të mirëmbajtjes, Porsche Bank është në rrugën e saj të suksesit. Me zyra në 15 vende të botës, Porsche Bank qëndron si kompania numër një në tregun e leasing-ut.

Fushat kryesore të aktivitetit të Porsche Bank janë financimi, sigurimi, mirëmbajtja (menaxhimin e flotës), dhe Europcar.

Fakti se më shumë se një e treta e automjeteve Volkswagen Group financohen nëpërmjet Porsche Bank, flet për cilësinë dhe kushtet e financimit të ofruara nga Porsche Bank, në Austri dhe anëtarët e grupit të të gjitha vendeve.

Porsche Insurance gjithashtu feston përvjetorin këtë vit. Gjatë 35 viteve të fundit, Porsche Insurance ka marrë kujdesin dhe sigurinë e klientëve të Porsche Bank, duke përfunduar më shumë se 350.000 kontrata të sigurimit casco ose të sigurimit të detyrueshem, në të gjitha tregjet ku Porsche Bank operon.

Menaxhimi profesional i flotës nëpërmjet Porsche Bank është një trend. Në vitin e kaluar, Porsche Bank ka konfirmuar leadershipin

e saj në tregun e menaxhimit të flotës. Në Austri, konsumatorët e mëdhenj kanë përfunduar 45.2% të kontratave të financimit nëpërmjet Porsche Bank.

Përveç shërbimit cilësor që Porsche Bank ofron në të gjitha fushat e operacioneve të saj në të gjitha tregjet, kujdesi dhe kënaqësia e konsumatorëve janë një përparësi. Në këtë fushë, dixhitalizimi po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për Porsche Bank, ku tashmë ka filluar disa projekte dhe vazhdon të investojë në të ardhmen dixhitale. Zhvillimi i biznesit financiar digital synon shërbim njëzet e katër orë, nuk ka rëndësi se ku konsumatorët ndodhen.

Në saj të reputacionit global, traditën, dhe eksperiencën e Porsche Holding të Austrisë, Grupi Financiar i Porsche në Shqipëri (përbërë nga Porsche Leasing dhe Porsche Mobility) ka paraqitur modelet të reja në financim apo dhe sigurimin e automjeteve, të cilat përputhen plotësisht e janë në mbështetje të standardeve më të larta europiane, duke u bërë kështu, zgjedhja e parë në financim për automjetet e grupit.

Në pothuaj 4 – vjecarin e parë të operimit, oferta me cilësi të lartë dhe një zgjedhje të gjerë të modeleve të financimit, mirëmbajtjes, dhe sigurimit të automjeteve, duke u plotësuar me zgjidhje teknologjike të klasit botëror si dhe besueshmërinë e makinave të VW Group, është dëshmi se Grupi Financiar i Porsche në Shqipëri, është partneri juaj më i mirë në financimin e automjeteve.

Në këtë fund vit, sikurse është bërë traditë, tashmë, ne i shprehim mirënjohjen dhe vlerësimin tonë klientëve tanë për besimin në zgjedhjen dhe bashkëpunimin me ne, duke u bërë pjesë e një zgjedhje globale si klientë të Porsche Bank!

Me këtë rast i urojmë klientëve, partnerëve të biznesit, kolegëve e miqve tanë, shëndet e mbarësi, suksese në realizimin e objektivave për vitin 2017!

Marjola Gurma

Drejtoreshë e Grupit Financiar Porsche në Shqipëri





The story of Porsche Financial Group began in 1966, when Porsche founded the first leasing company, based in Salzburg, Austria (today's Porsche Bank). Continued growth in the leasing business led in 1985 to the growth of the same company into a highly specialised financial institution with a focus on the sale of cars – Porsche Bank AG. In the early 1990s, Porsche recognised the opportunities emerging in the countries of Central and Southeast Europe, and the company expanded into countries such as Hungary, Romania, Slovakia, Slovenia, Serbia, Montenegro, Macedonia, Ukraine, Croatia, Albania, and Bosnia and Herzegovina. Today, Porsche Bank also operates in South America, in Colombia and Chile.

**Porsche Bank jubilee
50 years of business**

The development of Porsche Bank Group, from traditional Austrian enterprise to international mobility company, is amazing in its jubilee year too – with more than 900,000 financing, insurance, and maintenance contracts, Porsche Bank is on its way to success. With offices in 15 world countries, Porsche Bank stands as the number one company on the leasing market.

Key business areas of Porsche Bank are

financing, insurance, maintenance (fleet management), and Europcar.

The fact that more than a third of Volkswagen Group vehicles are financed through Porsche Bank speaks for the quality and terms of financing offered by Porsche Bank in Austria and in all countries' members of the group.

Porsche Insurance also celebrates an anniversary this year. Over the past 35 years, Porsche Insurance has taken care of the security of Porsche Bank clients, concluding more than 350,000 Casco insurance or liability insurance contracts on all Porsche Bank markets.

Professional fleet management through Porsche Bank is a trend. In the past year too, Porsche Bank confirmed its leadership on the fleet management market. In Austria, large customers concluded 45.2% of the financing contracts through Porsche Bank.

Besides the outstanding service that Porsche Bank provides in all areas of its operations on all markets, customer care and satisfaction are a priority. As, in this field, digitisation is becoming increasingly important, Porsche Bank has already started several projects and continues to invest in the digital future. Digital development of financial business is aimed at twenty-four-hour service, no matter where

customers are located.

Owing to the global reputation, tradition, and experience of the Austrian Porsche Holding, Porsche Financial Group in Albania (consisting of Porsche Leasing and Porsche Mobility) is introducing new products and models of financing, leasing, and car insurance, which fully comply with the highest European standards.

High-quality offer and a wide choice of models of financing, leasing, and vehicle insurance, complemented by world-class technological solutions and reliability of the VW Group cars, is proof that Porsche Financial Group Albania is your best partner on the way to exquisite vehicle.

At year end, we express our gratitude and appreciation for the trust our customers in choosing and collaborating with us, becoming part of a global choice as Porsche Bank clients!

On this occasion we wish customers, business partners, colleagues, our friends, health and prosperity, all the best for 2017!

Marjola Gurma

Head of Porsche Finance Group Albania





Me një gjatësi prej 4.70 m, deri në shtatë sedilje dhe bagazhin më të madh brenda klasës së saj, ŠKODA KODIAQ është makina e parë SUV e madhe e prodhuesit çek të makinave. Nga fillimi i vitit 2017, modeli më i ri i ŠKODA do të paraqitet me të gjitha pikat e forta të markës: dizajnin gjithë personalitet, hapësirë e brendshme të jashtëzakonshme, inteligjencë praktike dhe teknologji novatore që mund të gjendet vetëm në klasat më të larta të automjeteve. ŠKODA KODIAQ shënon fillimin e fushatës së gjerë të ŠKODA me SUV.

ŠKODA KODIAQ i ka të gjitha: SUV është e përshtatshme për biznes, si dhe për përdorim familjar dhe argëtim – dhe lëviz jashtë asfaltit me lehtësi. Marka e zhvendos gjuhën e saj të re të dizajnit në segmentin SUV me një dizajn që pasqyron karakterin e zhdërvjelltë: ŠKODA KODIAQ ka një kombinim të guximshëm linjash elegante, konture dhe forcë sportive, të cilat e bëjnë lehtësisht të dallueshme.

Sistemet e ndihmës për drejtuesin

Sistemi i Pamjes së Zonës vjen për herë të parë tek marka: kamerat me pamje përreth, të cilat janë të vendosura në seksionet ballore dhe fundore si dhe në pasqyrat anësore të ŠKODA KODIAQ, vijnë me lente me kënd të gjerë dhe lejojnë pamje të hapësirës përreth makinës dhe pasqyrohen në monitor. Këto përfshijnë një pamje virtuale, nga lart poshtë si dhe imazhe 180 gradë të hapësirave përpara dhe pas. Kjo e bën më të lehtë të drejtosh në situata çorientuese ose në terren të ashpër. Ndihi e Përparme (Front Assist) përfshin Frenimin e emergjencës në qytet, si pajisje standarde, dhe duke përdorur radarin, mund të pikasë situata të rrezikshme me këmbësorë ose automjete të tjera përpara makinës. Nëse

ka nevojë, sistemi e paralajmëron drejtuesin e mjetit dhe, kur duhet, aplikon frenat në mënyrë të pjesshme ose të plotë. Freni i Emergjencës për Qytet është aktiv deri në 34 km/orë. Mbrojtja Parashikuuese për Këmbësorin (Predictive Pedestrian Protection) plotëson Front Assist.

Motorët

Pesë seritë, dy motorë TDI dhe tri motorë TSI, përbëjnë gamën e motorave të ŠKODA KODIAQ. Ato kanë kapacitet prej 1.4 dhe 2.0 l, dhe me fuqi që variojnë nga 92 kW (125 PS) deri në 140 kW (190 PS). Motorët e naftës dhe benzinës kanë injeksion të drejtpërdrejtë turbocharge dhe përmbushin standardet EU6 për lëshimin e gazrave. Po ashtu, të gjithë motorët kanë një sistem Stop-Start, rikuperim të energjisë së frenave dhe një sistem të fuqishëm termo-menaxhimi, çka çon në konsum të ulët pavarësisht fuqisë së madhe që nxjerrin.

Modeli 2.0 TDI vjen në dy versione. Versioni i parë gjeneron 110 kW (150 PS) dhe 340 Nm. Versioni më i lartë nxjerr 140 kW (190 PS) dhe jep 400 Nm në bosht. Mesatarisht, kur plotësohet me kambio manuale me rrotat e para aktive, TDI fillestare konsumon 4.9 l naftë (129 g CO₂/km) për 100 km. Motori më i fuqishëm i naftës e rrit nivelin e shpejtësisë të SUV nga 0 në 100 km/orë në 8.9 sekonda dhe arrin shpejtësinë maksimale prej 210 km/orë. Gama e motorëve me naftë përbëhet nga dy motorë 1.4 TSI dhe një motor 2.0 TSI. Versioni fillestar i katër cilindrikut kompakt gjeneron 92 kW (125 PS) dhe 200 Nm forcë tërheqëse. Konsumi NEDC është 6.0 l për 100 km, çka i korrespondon 137 g CO₂/km. Në versionin më të fuqishëm, 1.4 litroshi ushtron 110 kW (150 PS) dhe 250 Nm forcë

tërheqëse; sistemi ACT – Teknologjia Aktive Cilindrike – mbyll cilindrat e dytë dhe të tretë kur ngarkesa dhe shpejtësia e motorit janë të ulëta. Varianti më i fuqishëm i motorit me naftë 2.0 TSI ka një proces të ri djegjeje për eficiencë të lartë. Motori nxjerr 132 kW (180 PS) dhe forca tërheqëse është 320 Nm.

ŠKODA Connect

Me zgjidhjet e saj për argëtimin informativ dhe lidhshmërinë, SUV e madhe e ŠKODA-s tregon se si një SUV mund të jetë gjithë kohën online. Me shërbimet e reja online që vijnë për herë të parë dhe që janë novatore, ŠKODA paraqet një dimension të ri navigimi, informimi dhe argëtimi.

